



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 201400650/2

Tiranë ____/____/2014

Lënda: *Rekomandojmë marrjen e masave për dërgimin sa më shpejt të jetë e mundur pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, të vërtetimit të datës 29.02.1992 të Kooperativës Bujqësor Kollovoz, me anë të të cilit vërtohen ditët e punës së bërë te shtetas M.M.*

Drejtuar : **Drejtorit të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore**

KUKËS

Zoti Drejtor,

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasja M.M.

Sipas shpjegimeve të saj dhe dokumentacionit bashkangjitur, sqarohemi se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, me vendimin nr.176 datë 19.05.2011 ka vendosur njohjen e faktit juridik të vjetërsisë në punë të kërkuases M.M, pranë ish Kooperativës Bujqësore Kollovoz (Shishtavec) për periudhën 1969-1978, sipas vërtetimit të datës 29.02.1992, lëshuar nga ish-Kooperativa Bujqësore Kollovoz. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr 630 datë 11.11.2013 të Gjykatës së Apelit Shkodër.

Duke qenë se aktualisht është banuese në Tiranë, ka depozituar vendimin e gjykatës pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë për ekzekutimin e tij.

Me shkresën nr.122 datë 10.03.2014 Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë i kthen përgjigje ankueses se duke qenë se gjykata nuk është shprehur për realizimin në fakt të ditëve të punës që u përket viteve 1969-1978 në Kooperativën Bujqësore Kollovoz, i është drejtuar institucionit tuaj me një shkresë zyrtare, por nuk ka marrë përgjigje. Kjo ka sjellë si pasojë që shtetas M.M të mos i njihen këto vite pune.

Duke e konsideruar këtë çështje si shkelje të të drejtave të ligjshme të saj, ankuesja ka kërkuar ndihmën e Avokatit të Popullit për të mundësuar pajisjen me vërtetimin e datës 29.02.1992, me qëllim llogaritjen e masës së pensionit të pleqërisë bazuar edhe në ditët e punës së bërë për periudhën 1969-1978.

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka vendosur pranimin e ankesës dhe shqyrtimin e saj.

Sa më lart, me qëllim që ankuesja të përfitojë atë ç'ka i takon, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*, si dhe në bazë të nenit 21/b të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se : *“Paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË:

Marrjen e masave për dërgimin sa më shpejt të jetë e mundur pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, të vërtetimit të datës 29.02.1992 të Kooperativës Bujqësor Kollovoz, me anë të të cilit vërtohen ditët e punës së bërë te shtetases M.M për periudhën 1969-1978.

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit Nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet shprehimisht se;

“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet të shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit”,

Lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijeni për qëndrimin Tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në bashkëpunimin Tuaj,

AVOKATI I POPULLIT
Igli TOTOZANI

Me Urdhër dhe me Porosi
ND/KOMISIONER
Frederik PASKALI